

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7005
E martë, 26 shtator 2023
Çmimi 0.50 €

Blinkeni dënon sulmet ndaj Policisë së Kosovës në veri



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

NJË ÇEREK SHEKULLI NGA REZOLUTA 1199 E KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB-SË. INTERVISTË EKSKLUZIVE ME ISH-PËRFAQËSUESIN POLITIK TË UÇK-SË, BARDHYL MAHMUTI

SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-së SI 'ORGANIZATË TERRORISTE'?

I alarmuar nga rreziku potencial i një katastrofe humanitare si pasojat e ofensivës së forcave të armatosura jugosllave të verës së vitit 1998, më 23 shtator 1998 Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi Rezolutën 1199. Për rëndësinë e kësaj rezolute të një çerek shekulli më parë dhe për çështje që lidhen me diplomacinë e UÇK-së, para disa ditësh kemi zhvilluar një intervistë ekskluzive me politologun Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

Le premier ministre yougoslave claque la porte du Forum de Crans-Montana
Le principal diplomate américain dans les Balkans, Richard Holbrooke, artisan des accords de paix en Bosnie, accable Belgrade
Serge Michel, Crans-Montana

Deklaratë politike nr.12
Duke i parë nga këtu në Ushtri Çlirimtare e Kosovës nuk i ka mbetur asnjë...
SHTABI I PËRGJITHSHËM I USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS



OPINION

PËRPPJEKJA PËR KRYENGRITJE SI MOMENTUM I RI

Hajdin ABAZI



AKTUALE



POLICIA EKSPONON ARMATIMIN E SEKUESTRUAR NË ZVEÇAN

EMISARI GJERMAN KËRKON ZGJIDHJE PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË OHRIT

LAJÇAKU: DO TA GJEJ NJË RRUGË PËRPARA NË DIALOG NË DITËT NË VIJIM

EKONOMI



GUVERNATORI ISMAILI MERR MBËSHTETJE NGA BE-ja PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE TË BQK-së

ATK-ja NDRYSHON PROCEDURAT E RIMBURSIMIT

SPORT

FEDERATA E KARATESË PARALAJMËRON PADI NDAJ MKRS-së

RRESHTERI AFRIM BUNJAKU VARROSET ME NDERIMET MË TË LARTA SHTETËRORE I JEPET LAMTUMIRA RRESHTERIT BUNJAKU



- Presidentja Osmani shpall hero të Kosovës rreshterin Afrim Bunjaku

I është dhënë lamtumira e fundit rreshterit të Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku, i cili është vrarë të dielën në veri të vendit në përballje me bandat kriminale serbe. Në ceremoninë e varrimit kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve, të partive politike, ambasadorë të

vendeve mike dhe qytetarë të shumtë. Para se të përcillet për në banesën e fundit, presidentja Vjosa Osmani e ka shpallur rreshterin Bunjaku hero të Kosovës. Ajo ka thënë se Bunjaku ka sakrifikuar jetën për mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Blinkeni dënon sulmet ndaj Policisë së Kosovës në veri

UASHINGTON, 25 SHTATOR - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka thënë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dënojnë fuqishëm sulmet ndaj Policisë së Kosovës në veri të shtetit, duke u bërë thirrje Qeverisë të Kosovës dhe asaj të Serbisë, t'i ulin tensionet. Blinkeni ka thënë se autorët e vrasjes së rreshterit të policisë Afrim Bunjaku duhet të mbahen përgjegjës përmes një procesi transparent të hetimit. "Ne u bëjmë thirrje Qeverisë së Kosovës dhe të Serbisë të përmbahen nga çdo veprim apo retorikë që mund të nxisë më tej tensionet, dhe menjëherë të punojnë, në koordinim me partnerët ndërkombëtarë, për shtensionimin e situatës, të

ofrojnë siguri dhe sundim të ligjit dhe t'i kthehen dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian", ka thënë ai. Sipas kryediplomatit amerikan, Policia e Kosovës "ka përgjegjësi të plotë për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës". "ShBA-ja njeh dhe respekton rolin e Policisë së Kosovës si reaguesja e parë për situata të emergjencës dhe krizave", ka thënë Blinkeni. Më tutje, Blinkeni ka thënë se Uashingtoni e vlerëson koordinimin e ngushtë me Policinë e Kosovës, misionit të BE-së për Sundim të Ligjit (EULEX) dhe atë të KFOR-it, "veçmas për të ofruar siguri për civilët në vendngjarje", duke shtuar se ShBA-ja do të vazhdojë ta monitorojë situatën.



Emisari gjerman kërkon zgjidhje për zbatimin e marrëveshjes së Ohrit



PRISHTINË, 25 SHTATOR - Emisari gjerman Manuel Sarrazin ka thënë se duhet të ecet përpara për gjetjen e një zgjidhjeje për zbatimin e marrëveshjes së Ohrit. Sipas tij, është shumë e rëndësishme situata e sigurisë në veri dhe reagimi për një gjë të tillë duhet të jetë i qartë. Pas takimit me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, Sarrazin ka thënë se nëse kërkohet zgjidhje për veriun, duhet pasur një dialog të suksesshëm. I pyetur se sa është e mundur që dialogu të vazhdojë, Sarrazin ka thënë se nuk ka ndonjë informatë, por që thotë se duhet të punohet nga të dyja palët. "Ne mundohemi të bëjmë më të mirën tonë, që të tregojmë se në fund ne jemi miq të Ballkanit Perëndimor dhe duam t'u ndihmojmë të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian. Ky është një rrugëtim që do të udhëhiqet nga dialogu. Kancelari im ka qenë i qartë kur vizitoi Prishtinën para një viti e tre muajsh, por sigurisht kultura politike dhe vendimmarrja politike nuk mund të bëhet nga

Gjermania. Ne vetë mund t'i mbështesim miqtë tanë për marrjen e këtyre hapave. Siç thashë më parë, kjo nuk është dita për të biseduar për këto çështje, por është për të shprehur solidaritet", ka thënë ai, duke shtuar se dialogu mund të vazhdojë. "Dialogu sigurisht mund të vazhdojë, dhe është e rëndësishme që ne të qëndrojmë në rrugën e të arriturit të implementimit të marrëveshjes së Ohrit. Çka unë dëgjoj në Beograd dhe në Prishtinë është se marrëveshja e Ohrit është një gurthemel që mund të çojë në një drejtim shumë pozitiv të marrëdhënieve. Por, siç e shohim, për momentin nuk është duke u implementuar në mënyrë të suksesshme dhe mendoj se ky nuk është momenti që të ndalojmë së përpjekuri që kjo marrëveshje të implementohet në mënyrë të suksesshme. Nuk kam informacion që mund të ndaj me ju, por mendoj se sa kapitali politik do të investoj në dialog do të tregojë sa ky dialog do të jetë i suksesshëm", ka thënë ai.

Lajçaku: Do ta gjej një rrugë përpara në dialog në ditët në vijim

Bruksel, 25 shtator - I dërguari i Bashkimit Evropian (BE) për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka thënë të hënën se do të përqendrohet ditët në vijim për të gjetur një rrugë përpara në dialog, pas sulmit më armë ndaj Policisë së Kosovës në veri të vendit, ku është vrarë rreshteri i policisë Afrim Bunjaku.

Lajçaku ka thënë se ka mbetur i tronditur nga sulmi ndaj zyrtarëve të Policisë së Kosovës në fshatin Banjskë të Zveçanit. "Akte të tilla të dhunës janë thellësisht shqetësuese dhe janë kundër parimeve të paqes dhe bashkëpunimit", ka thënë ai. Më tutje, Lajçaku ka thënë se ky sulm e thekson edhe më

shumë nevojën për dialog dhe diplomaci parandaluese "e cila u nënvizua gjatë javës së kaluar kur mora pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork". "Për të gjetur një rrugë përpara në rajon, në veçanti në dialog, unë kisha bisedime strategjike me partnerët tanë amerikanë", është shprehur Lajçaku.



RRESHTERI AFRIM BUNJAKU VARROSET ME NDERIMET MË TË LARTA SHTETËRORE

I jepet lamtumira rreshterit Bunjaku

- Presidentja Osmani shpall hero të Kosovës rreshterin Afrim Bunjaku

I është dhënë lamtumira e fundit rreshterit të Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku, i cili është vrarë të dielën në veri të vendit në përballje me bandat kriminale serbe. Në ceremoninë e varrimit kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve, të partive politike, ambasadorë të vendeve mike dhe qytetarë të shumtë. Para se të përcillet për në banesën e fundit, presidentja Vjosa Osmani e ka shpallur rreshterin Bunjaku hero të Kosovës. Ajo ka thënë se Bunjaku ka sakrifikuar jetën për mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës

EPOKA
ERE

Lirim GECI

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Me pjesëmarrjen e një numri të madh të qytetarëve dhe përfaqësuesve të institucioneve dhe të partive politike, të hënë në është dhënë lamtumira e fundit rreshterit të Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku, i cili është vrarë të dielën në ballafaqim me bandat kriminale në veri të vendit. Në ceremoninë mortore ka marrë pjesë edhe përfaqësuesi i familjes emblematike Jashari, Rifat Jashari. Po në këtë ceremoni kanë marrë

Bunjaku ra dëshmor e u bë hero i Kosovës për ta ngritur shtetin tonë. Afrim Bunjaku ra në krye të detyrës si oficer i denjë i Republikës në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe sovranitetit të Republikës sonë”, ka thënë ai.

Në anën tjetër, kryeministri Albin Kurti ka thënë se Afrim Bunjaku është dëshmori më i ri i Republikës së Kosovës. Ai ka thënë se kontributi i tij do të përkujtohet gjithmonë.

Kurse familjari i rreshterit Afrim Bunjaku, Artani, i ka falënderuar të gjithë pjesëmarrësit për pjesëmarrje në ceremoninë e



policisë sonë që me veprimet e saj profesionale dhe të guximshme parandaloi një skenar kriminal dhe terrorist”, ka thënë Kurti, duke shtuar se Afrim Bunjaku është vrarë gjatë një sulmi nga një grup terrorist. “Nga dje asgjë nuk mund të jetë më njësoj. Faktet dolën për ta parë të vërtetën e rajonit. Ky reagim i institucioneve tona profesionalisht ka qenë në përputhje me shtetin tonë demokratik dhe perëndimor. Sot përballë fotografisë së portretit të Afrim Bunjakut përkulemi me nderime dhe respekt si dhe zotohemi për drejtësi dhe kujtesë. Ligjshmëri dhe kushtetutshmëri, paqe dhe siguri për të gjithë dhe secilin pa dallim”, ka thënë Kurti. Ndërsa ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka thënë se me vrasjen e policit Afrim Bunjaku, Kosova ka humbur një njeri dhe polic të mrekullueshëm. Sveçla ka thënë se, përveç dhimbjes, ndien edhe krenari për Bunjakun e se në ditë si këto dhimbjen duhet ta kthejmë në forcë. “Kësaj dhimbjeje që po e ndiej po i shtohet edhe krenaria që e kishim fatin ta kemi rreshterin Bunjaku në radhët tona”, ka thënë Sveçla.

Vajza e rreshterit Bunjaku: Babai im është flijuar për lirinë e vendit

Në mbledhjen përkujtimore kushtuar rreshterit Afrim Bunjaku ka marrë pjesë edhe vajza e tij, Arbenita Bunjaku ka thënë se babai i saj është flijuar për lirinë e vendit. Me fjalimin për babanë, ajo i ka emocionuar të pranishmit, duke thënë se “mbeta jetim para kohe, si të jetojë pa ty?”.

Arbenita ka shprehur krenari për veprën e babait. “Heroi im, babai im! Sa vështirë e kam të shkruaj për ty. Para kohe mbeta jetime. Kurrë s’e kam besuar. Ikja jote na la një plagë. Si të jetoj unë pa ty? Hyra brenda në shtëpi dhe nuk të pashë ... por si të jetojmë pa ty? Babi, ti ishe një njeri i dashur. E flijove veten për liri, për këtë vend që ne dhe Kosova të gjithë të jemi krenarë për ty dhe heroizmin tënd”, ka thënë ajo.

Afrim Bunjaku pas vetes ka lënë vajzën, dy djemtë dhe gruan.



pjesë edhe ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Jeffrey Hovenier, shefi i BE-së, Tomas Szunyog etj. Bunjaku është varrosur në Samadrexhë të Vushtrisë me nderime të larta shtetërore. Presidentja Vjosa Osmani në këtë ceremoni ka thënë se kontributi i rreshterit Bunjaku nuk do të harrohet asnjëherë. Osmani ka thënë se do të qëndrojnë pranë familjes Bunjaku. “Ai nuk ishte vetëm mbrojtës i Republikës, por edhe simbol i guximit. Sakrificat juaj nuk do të harrohet kurrë tekta trashëgimia juaj qoftë frymëzim për brezat e ardhshëm se si duhet të mbrohet atdheu!”, ka thënë Osmani.

Ndërsa kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka thënë se rreshteri Bunjaku ka mbrojtur Kosovën me trupin e tij. Ai ka thënë se Bunjaku do të jetë udhërrëfyes se si mbrohet atdheu. Konjufca ka thënë se vrasja e Bunjakut është dëshmia më e mirë se Serbia nuk ka ndryshuar. “Dita e 24 shtatorit do të shënohet në historinë e Kosovës sikur dita kur Afrim

varrimit. Ai ka thënë se Afrimi është dëshmori dhe heroi i të gjithë shqiptarëve.

Vrasja e rreshterit Afrim Bunjaku dhe plagosja e policit Alban Rashiti është dënuar ashpër nga përfaqësuesit e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.

Rreshteri Bunjaku shpallet hero i Kosovës

Para ceremonisë së varrimit, presidentja Vjosa Osmani e ka shpallur hero të Kosovës rreshterin Afrim Bunjakun. Titullin e tij hero e kanë pranuar dy djemtë e rreshterit Bunjaku.

Osmani në mbledhjen përkujtimore kushtuar heroit më të ri të Kosovës, ka theksuar se Bunjaku ka sakrifikuar jetën për sigurinë e të gjithë qytetarëve. “Jemi mbledhur në këtë ceremoni mortore për t’ia dhënë lamtumirën e fundit policit tonë, rreshterit Afrim Bunjakut, i cili deri dje ishte gardian i sigurisë sonë, ndërsa nga sot është hero i

Kosovës. Ai ra në mbrojtje të rendit, ligjit, integritetit territorial dhe sovranitetit të Kosovës. Sot në emër të qytetarëve të Republikës së Kosovës do t’i ndajë urdhrin më të lartë të Republikës, urdhrin Hero i Kosovës”, ka thënë Osmani, duke e quajtur rreshterin Bunjaku trim dhe vetëmohues. “Shteti ynë nga sot ka edhe një herë një kujtim më shumë, i cili me profesionalizëm dhe përkushtim iu dedikua mbrojtjes së republikës, për të cilën ra në krye të detyrës, sot po nderojmë një hero të vërtetë, një rreshter trim dhe vetëmohues, i cili sakrifikoi jetën për sigurinë e të gjithë qytetarëve tanë”, është shprehur Osmani.

Ndërsa kryeministri Albin Kurti, ka thënë se rreshteri Afrim Bunjaku tashmë është hero i Kosovës. Ai ka vlerësuar se të dielën Policia e Kosovës ka treguar profesionalizëm, duke parandaluar një skenar kriminal dhe terrorist në veri të vendit. Në mbledhjen përkujtimore kushtuar Bunjakut, Kurti ka thënë se ligjshmëria, kushtetutshmëria,

paqja dhe siguria do të jenë gjithmonë dhe çdoherë për gjithsecilin dhe pa dallime. “E diela e 24 shtatorit na ka mbledhur sot këtu dhe shpirtërisht gjithë Kosovën për ta nderuar jetën dhe veprën e rreshter Afrim Bunjakut. Dita e sotme është ditë zie në vendin tonë për shkak të pikëllimit për Afrim Bunjakun. Por, e sotmja është edhe dita kur do t’i bëhen nderimet më të mëdha Afrimit,





NJË ÇEREK SHEKULLI NGA REZOLUTA 1199 E KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB-SË. INTERVISTË EKSKLUZIVE ME ISH-PËRFAQËSUESIN POLITIK TË UÇK-SË, BARDHYL MAHMUTI

Si u hoq cilësimi i UÇK-së si 'organizatë terroriste'?

I alarmuar nga rreziku potencial i një katastrofe humanitare si pasojat e ofensivës së forcave të armatosura jugosllave të verës së vitit 1998, më 23 shtator 1998 Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi Rezolutën 1199. Për rëndësinë e kësaj rezolute të një çerek shekulli më parë dhe për çështje që lidhen me diplomacinë e UÇK-së, para disa ditësh kemi zhvilluar një intervistë ekskluzive me politologun Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

PRISHTINË, 25 SHTATOR -

"Epoka e re": I alarmuar nga rreziku potencial i një katastrofe humanitare si pasojat e ofensivës së forcave të armatosura jugosllave të verës së vitit 1998, më 23 shtator 1998 Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi Rezolutën 1199. Çfarë do të veçonit nga kjo rezolute dhe cili ishte qëndrimi politik i UÇK-së në atë kohë?

Bardhyl Mahmuti: Që të kuptohet domethënia dhe rëndësia e kësaj rezolute më duhet të përmend disa fakte që

lidhen me kontekstin e zhvillimeve dramatike të asaj kohe, duke filluar nga marsi i vitit 1998. Pas krimeve që kryen forcat serbe ndaj shqiptarëve gjatë tërë muajit mars, më 31 mars 1998, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara miratoi Rezolutën 1160. Në paragrafin tre të kësaj rezolute tekstualisht shkruhej se Këshilli i Sigurimit: "Dënonte përdorimin e tepërt të forcës nga ana e forcave të armatosura të policisë serbe kundër civilëve dhe manifestuesve paqësorë në

Kosovë si dhe të gjitha aktet terroriste të kryera nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës ose nga çfarëdo grupi apo individ tjetër. Në të njëjtën kohë dënohej çfarëdo mbështetje e jashtme për aktivitete terroriste në Kosovë, sidomos në formë të burimeve financiare, të armëve apo trajnimeve". Përveç mënyrës sesi e trajtonin luftën, po përmend edhe një element shumë të rëndësishëm: në pikën 17 të kësaj rezolute Këshilli i Sigurimit e angazhoi Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavi "të fillonte grumbullimin e informatave lidhur me aktet e dhunës në Kosovë". Duke trajtuar krimet në kuadër të "akteve të dhunës", kjo rezolute përjashtoi ta konsideronte luftën në Kosovë si "konflikt i armatosur", pra në të njëjtën cilësi si luftërat në Slloveni, në Kroaci dhe në Bosnjë-Hercegovinë.

"Epoka e re": Domethënë krimet serbe cilësoheshin si "dhunë e tepëruar", kurse veprimet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës si "akte terroriste", së cilës duhej t'i ndërpritej mbështetja e jashtme financiare, ajo me armë dhe trajnimet?! Çfarë dallon rezoluta e miratuar gjashtë muaj më vonë, më 23 shtator 1998?

Bardhyl Mahmuti: Fillimisht duhet të përmendet se si pasojë e ofensivës gjenocidale të Forcave të Armatosura Serbe në Kosovë ishin vrarë mbi 2 000 civilë shqiptarë, ishin rrënuar mijëra shtëpi dhe prona shqiptarësh dhe qindra mijëra të tjerë ishin detyruar t'i braktisnin vatrat e tyre. Rezoluta 1199 shprehte qartë brengosjen e Këshillit të Sigurimit të OKB-së për "përdorimin e dhunës së tepërt dhe të padiskriminuar të forcave serbe të sigurisë policore dhe atyre ushtarake jugosllave, të cilat kanë shkaktuar vrasjen e shumë viktima civile dhe, sipas

vlerësimeve të Sekretarit të Përgjithshëm, zhvendosjen e më shumë se 230 mijë personave (...) 50 mijë prej të cilëve kishin mbetur të pa strehë". Ky realitet bëri që situata të cilësohej si rrezik që së shpejti të ndodhte një katastrofë humanitare. Përveç kësaj, në paragrafin pesë të rezolutës theksohet se KS i OKB-së "ishte në dijeni se më 7 korrik 1998 në letërën që Prokurori i Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë i kishte drejtuar Grupit të Kontaktit vlerëson se situata në Kosovë përbën një konflikt të armatosur në kuptimin e termave të mandatit të kësaj Gjykate". "Përkeqësimi i situatës në Kosovë përbente rrezik për paqen dhe sigurinë e rajonit" dhe, rrjedhimisht, kjo çështje duhej të trajtohej në kuadër të Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Këto aspekte paraqesin një hap të madh në drejtim të trajtimit të çështjes së

Kosovës në të njëjtin nivel si ishin trajtuar çështjet e tjera në procesin e shpërbërjes së Federatës së Jugosllavisë.

“Epoka e re”: A ndryshoi diçka në këtë rezolutë që lidhet me qëndrimin ndaj luftës sonë çlirimtare?

Bardhyl Mahmuti: Për dallim nga rezoluta e 31 marsit 1998, ku aktet terroriste i atribuoheshin Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në rezolutën e 23 shtatorit 1998 dënoheshin të gjitha aktet e dhunës të kryera nga të gjitha palët si dhe aktet terroriste të kryera për motive politike nga të gjitha grupet dhe nuk përmendej aspak Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

“Epoka e re”: Sipas jush, çfarë ndikoi që të ketë një lëvizje të tillë të institucioneve ndërkombëtare?

Bardhyl Mahmuti: Mosnjohja e së vërtetës për luftën tonë çlirimtare dhe ndikimi i propagandës aktive serbe në rrafshin diplomatik kishin ndikuar në perceptimin negativ të luftës sonë dhe në cilësimin e veprimeve të UÇK-së si “akte terroriste”. Mirëpo gjërat ndryshuan me krijimin e mundësive e vendosjen e kontakteve me diplomatët e shteteve relevante të skenës politike ndërkombëtare. Gjatë këtyre takimeve ne kemi arritur t’i shpalosim qëllimet dhe metodat që përdorte Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Po përmend dy ngjarje që shënojnë çaste kthese të luftës sonë diplomatike: Më 26 qershor të vitit 1998, dy ditë para mbajtjes së një mbledhjeje të Grupit të Kontaktit për ish-Jugosllavinë, ku do të shqyrtohej situata në Kosovë, së bashku me Ramadan Avdiun u takuam me një delegacion prej tetë anëtarësh të Departamentit të Shtetit Amerikan dhe Pentagonit. Delegacionin amerikan e udhëhiqte ambasadori Robert Gelbard. Në këtë takim, që zgjati rreth pesë orë, u kërkua nga ne që ta sqaronim platformën e UÇK-së. Takimin e konsideruam të suksesshëm, sepse në mbrëmje të asaj dite, zëdhënësi i Departamentit të Shtetit, Xhems Rubin, doli në konferencë për shtyp dhe e konfirmoi takimin që kemi pasur. Për ne ishte e një rëndësie të madhe fakti se për herë të parë institucionet shtetërore të ShBA-së hodhën poshtë cilësimin “terrorist” që i vishej UÇK-së dhe deklaruan haptas se UÇK-ja duhej të përfshihej në bisedimet për ardhmërinë politike të Kosovës. Ngjarja tjetër e rëndësishme ndodhi më 27-28 qershor 1998. Në Zvicër mbahej Forumi i Crans Montanas (Krans Montana). Me ftesë të ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në



Zvicër, z. Vladimir Thanati, së bashku me Ramadan Avdiun, shkuam ta takonim kryeministrin e Shqipërisë, z. Fatos Nano, i cili merrte pjesë në këtë forum. Kryeministrin Nano e njoftuam për angazhimet tona, vështirësitë që kishim dhe nevojën që diplomacia shqiptare të na ndihmonte aty ku ne nuk kishim mundësi të depërtonim. Rreth orës 20:00 të asaj dite më mori në telefon kryeministri Nano dhe më njoftoi se duhej të nisesha për në Crans Montana, sepse më kishte siguruar një takim me ambasadorin amerikan z. Richard Holbrooke, në orën 23:00. Sado e çuditshme që m’u duk ora e takimit (pak para mesnate!), situata në Kosovë ishte tepër dramatike që përjashtonte çfarëdo farse që zakonisht i bëjnë politikanët njëri-tjetrit. U nisa menjëherë! Takimi, që ishte i një rëndësie të madhe, filloi në orën 23:00 dhe zgjati deri në 04:45 të mëngjesit. Ishte një takim tepër i suksesshëm. Në konferencën për shtyp të asaj të diele të 28 qershorit 1998, gazetarët e pyetën për vërtetësinë e pohimeve të gazetës “The New York Times” për kontaktet e ambasadorit Robert Gelbard me përfaqësues të UÇK-së. Ambasadori Richard Hollbruk pohoi për takimin e vet dhe atë të ambasadorit Robert Gelbard me përfaqësues të UÇK-së dhe deklaroi: “Gjatë dhjetë viteve të fundit serbët kanë krijuar rrethanat e revoltës. E hoqën autonominë e krahinës, i mbyllën shkollat, i dërguan njerëzit nëpër burgje. Kosovarët dëshirojnë tjetër statut. Duhet t’u jepet një gjë e tillë”. Pas përgjigjes për domosdoshmërinë e dhënies së statutit politik Kosovës, gazetarët kërkuan të dinin qëndrimin e z. Holbrooke lidhur me këmbënguljen e UÇK-së për ta realizuar pavarësinë nga Serbia. Ambasadori Holbrooke deklaroi se ShBA-ja nuk e përjashtonte pavarësinë e Kosovës si zgjidhje, nëse një gjë e tillë do të bëhej në mënyrë analogjike siç ndodhi me

ndarjen e Çekisë nga Sllovakia. Ishte hera e parë që një diplomat i këtij rangu linte dyert e hapura për kërkesën tonë për pavarësi. Meqë ra fjala për Samitin e mbajtur në Crans Montana, e shoh të rëndësishme për lexuesit të sjell edhe një ngjarje. Qëndrimet e ambasadorit Holbrooke revoltuan tej mase kryeministrin e Jugosllavisë, Momir Bullatović, i cili deklaroi: “Ata që kanë rrokur armët në Kosovë janë terroristë të financuar nga paraja e drogës në Zvicër dhe në Gjermani” dhe u

ACCUEIL > MONDE

Le premier ministre yougoslave claque la porte du Forum de Crans-Montana

Le principal diplomate américain dans les Balkans, Richard Holbrooke, artisan des accords de paix en Bosnie, accable Belgrade

Serge Michel, Crans-Montana

La délégation yougoslave à Crans a réagi très amèrement aux propos de Richard Holbrooke. «Ceux qui ont pris les armes au Kosovo sont des terroristes financés par l'argent de la drogue en Suisse et en Allemagne, a lancé un haut fonctionnaire. Nous ne comprenons pas pourquoi les Etats-Unis mettent toute la pression sur nos épaules. Ils doivent poursuivre des objectifs qui nous échappent.»

Le premier ministre yougoslave, Momir Bultovic, a quitté la station valaisanne en claquant la porte après un dernier camouflet: la suppression en dernière minute d'une séance sur la sécurité en Europe à laquelle il avait été convié à participer aux côtés de Richard Holbrooke et du premier ministre albanais Fatos Nano.

Deklaratë politike nr.12

Duke u nisur nga fakti se Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk i ka rrokur armët se e ka dashur luftën, por për të krijuar kushte për zgjidhjen e çështjes së popullit shqiptar në një Kosovë të lirë, të pavarur dhe demokratike;

Duke e parë angazhimin e bashkësisë ndërkombëtare për përfundimin e tragjedisë civile në Kosovë, dhe duke pasur parasysh kërkesën e dalë nga Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të datës 23 shtator 1998, Ushtria Çlirimtare e Kosovës merr vendimin që të vetëpërbahet në mënyrë që të japë kontributin e saj për realizimin e Rezolutës së KS të OKB-së.

Zbatimi i këtij vendimi fillon që nga data e nesërme, 9 tetor 1998, dhe do të vlejë gjatë tërë kohës së veprimeve ushtarake të NATO-s.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës në këtë drejtim kërkon krijimin dhe vendosjen e një sistemi ndërkombëtar të verifikimit për të kontrolluar realizimin e këtij vendimi dhe kërkesat që dalin nga rezoluta.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës gjatë tërë kësaj periudhe do të dëshmojë vetëpërbajtje, por njëkohësisht ruan edhe të drejtën e kundërpërgjigjes në rast se pala kundërshtarë nuk e respekton këtë.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës do të japë kontributin e saj maksimal për t’ua lehtësuar organizmave ndërkombëtare veprimet e tyre të papengueshme në Kosovë.

Prishtinë, 8 tetor 1998

**SHTABI I PËRGJITHSHËM
I USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS**

largua nga Crans Montana.

“Epoka e re”: Kur kemi të bëjmë me këto takime, qoftë në intervista me shkrim, qoftë në intervista televizive, z. Xhavit Haliti ka deklaruar disa herë se ai ju ka autorizuar të takoheni me ambasadorët amerikanë. Ju asnjëherë nuk jeni deklaruar

rreth kësaj çështjeje. Si u organizuan këto takime diplomatike?

Bardhyl Mahmuti: Është e vërtetë se për takimin me delegacionin amerikan të udhëhequr nga z. Gelbard, Xhavit Haliti më ka njoftuar se unë dhe Ramadan Avdiu duhej ta përfaqësonim UÇK-në këtë takim. Ndërsa

takimi me z. Holbrooke, siç thashë më parë, është organizuar falë ndihmës së madhe të kryeministrin të Shqipërisë në atë kohë, Fatos Nano. Gjithashtu, është e vërtetë se z. Xhavit Haliti, i cili gjatë asaj kohe rrinte në Shqipëri, e kam njoftuar jo vetëm për këto dy takime, por për të gjitha takimet diplomatike që

kemi zhvilluar si Grup Diplomantik i UÇK-së deri në kohën kur z. Adem Demaçi hapi Zyrën e UÇK-së në Prishtinë. Pas krijimit të Zyrës së UÇK-së në Prishtinë, çdo njoftim ia kam dërguar z. Demaçi.

“Epoka e re”: Me një fjalë, falë angazhimit diplomatik për ta sqaruar orientimin politik dhe format e luftës që zbatonte UÇK-ja dhe mbështetjes që gjetën këto sqarime te diplomatët amerikanë, në Rezolutën 1199 u hoq ndërlikohja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me aktet terroriste.

Bardhyl Mahmuti: Plotësisht e saktë! Kjo ishte një fitore e madhe për luftën tonë të drejtë!

“Epoka e re”: Në funksion të ruajtjes së paqes dhe sigurisë, Këshilli i Sigurimit kërkonte nga të gjitha palët që menjëherë t’i ndërprinin armiqësitë, të arrihej një armëpushim dhe të vendosej një Mision Verifikues i OSBE-së për ta mbikëqyrur respektimin e kushteve të vendosura me anë të kësaj rezolute. Dy javë pas miratimit të kësaj rezolute, UÇK-ja shpalli armëpushim. Si ndodhi kjo?

Bardhyl Mahmuti: Në kontekstin që përmendët në pyetjen tuaj, në orët e vona të datës 7 tetor 1998, nëpërmjet telefonit më kontaktoi ambasadori Richard Holbrooke dhe më caktoi takim për ditën e nesërme, në orën 8:00 të mëngjesit, në Selinë e NATO-s

në Bruksel. Përveç z. Holbrooke, në takim ishte i pranishëm komandanti i NATO-s, z. Wesley Clark, dhe ambasadori i ShBA-së, Lawrence Rosin (i njohur si Lari Rosin). Qëndrimet e tyre ishin të qarta: pala që nuk do t’i respektonte kërkesat kategorike të Këshillit të Sigurimit për armëpushim do t’i bartte pasojat. Këshilli i NATO-s e kërcënoi Serbinë me sulme ajrore në rast të mosrespektimit të këtyre kërkesave, ndërsa ne ballafaqoheshim me kërcënimin e ndalimit të të gjitha mundësive për ta ndihmuar UÇK-në me mjetet e nevojshme. Përpara udhëtimit për në Beograd, ambasadori Holbrooke kërkoi që Ushtria Çlirimtare e Kosovës ta shpallte armëpushimin dhe ky veprim do t’ia pamundësonte Slllobodan Millosheviqit t’u shmangej obligimeve që i dilnin nga kjo rezolute. Duke parë interesin jetik që kishte për popullin shqiptar ndërprerja e luftës dhe krijimi i mundësisë që nëpërmjet dialogut të ndërmjetësuar nga aktorët kryesorë të skenës politike ndërkombëtare, t’u jepej një shans përpjekjeve diplomatike për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, pa konsultuar askënd pranova kërkesën e tyre. Për të mos humbur kohë derisa të kthehesha nga Brukseli dhe të vija kontakte me Adem Demaçin, z. Holbrooke i diktoi

Lari Rosin tekstin model se si do të dukej një deklaratë për shpallje të armëpushimit, Lari Rosini e përktheu në frëngjisht, ndërsa unë e përshtata tekstin në përputhje me rrethanat tona. Kur e përfundova redaktimin u mundova të komunikoj me z. Adem Demaçi, por ai ishte jashtë rrjetit të valëve. Edhe përpjekja për të kontaktuar me Xhavit Halitin doli e kotë. Meqenëse nuk mund ta dija se pas sa kohe do ta vendosja kontaktin me z. Demaçi ose me z. Haliti, unë thirra në Zvicër (Kadri Veselin, Bilall Sherifin dhe Ramadan Avdiun) ua diktova tekstin dhe i porosita t’ia përcillnin qoftë z. Demaçi, qoftë z. Haliti. Të tre ishin të mendimit se duhej t’u jepej një shans përpjekjeve diplomatike për zgjidhje të çështjes së Kosovës nëpërmjet dialogut të ndërmjetësuar dhe më sugjeruan t’ua dërgoja medieve. Përkundër nevojës së madhe që armëpushimi të shpallej sa më parë, u pajtuam se një veprim i tillë duhej të bëhej nga Prishtina, sepse tanimë kishim Zyrën e UÇK-së në kryeqytet. Përveç kësaj, z. Adem Demaçi kishte mundësi që brenda 24-orësh të bënte një njoftim në të katër anët e Kosovës.

“Epoka e re”: Kush ia përcolli tekstin Zyrës së UÇK-së në Kosovë?

Bardhyl Mahmuti: Ka kaluar një çerek shekulli nga ajo kohë dhe njerëzve nuk u kujtohet saktësisht. Nëse nuk ka shkuar porosia nga të tria drejtimet, për një jam i sigurt: Ramadan Avdiu personalisht ka vënë kontakt me Zyrën në Prishtinë dhe ua ka diktuar tekstin.

“Epoka e re”: Deklarata është e datës 8 tetor 1998. Duke parë situatën dramatike në Kosovë, për çfarë arsye armëpushimi hyri në fuqi një ditë më vonë?

Bardhyl Mahmuti: Shpalljen e menjëhershme të armëpushimit e kërkonte edhe ambasadori Holbrooke. Mirëpo mungesa e një komande qendrore që e ka karakterizuar UÇK-në dhe vështirësitë e komunikimit impononin shtyrjen e kohës për së paku 24 orë që të kemi mundësi t’i njoftojmë të gjitha mediet dhe në këtë mënyrë të njoftohen radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për armëpushimin. Për shkak të mungesave të shumta që kishim, hyrja në fuqi e armëpushimit më 8 tetor bartte me vete rrezikun që shumica e strukturave të UÇK-së të mos ishte në dijeni dhe të ndërmerre ndonjë aksion kundër forcave të okupatorit. Me një veprim të tillë do ta humbnim besimin dhe vështirë se do të arrinin të ndërtonim raporte serioze me aktorët kryesorë në marrëdhëniet ndërkombëtare.

“Epoka e re”: Pavarësisht prej armëpushimit dhe vendosjes së 2 000 pjesëtarëve civilë dhe të paarmatosur të shteteve anëtare të OSBE-së për Misionin e Verifikimit në Kosovë, Slllobodan Millosheviqi nuk e ndali projektin e vet për gjenocid në Kosovë. Cilat ishin efektet diplomatike të asaj periudhe?

Bardhyl Mahmuti: Prania ndërkombëtare në Kosovë nuk e parandaloi zbatimin e politikës së gjenocidit në Kosovë. Megjithatë, nuk e di se çfarë kahe do të kishin marrë ngjarjet nëse nuk do të kishin qenë në terren pjesëtarët e Misionit Verifikues në Kosovë. Guximi i kreut të këtij misioni, diplomatit amerikan William Walker, për ta shpallur përpara opinionit publik ndërkombëtar aktin gjenocidial në fshatin Reçak, krijoi një dinamikë të tillë të mobilizimit ndërkombëtar që rezultoi me Konferencën Ndërkombëtare në Rambouillet të Francës, refuzimi i Serbisë për ta nënshkruar marrëveshjen, ndërhyrja ushtarake e NATO-s dhe përfundimi i luftës! Kam bindjen e plotë se serioziteti që kemi treguar në çaste vendimtare ka ndikuar që të arrijmë deri te çlirimi i vendit dhe realizimi i pavarësisë së Kosovës, me të gjitha mangësitë që ka!

(Muhamet MAVRAJ / 15.09.2023)



Kupchan: Sulmi në Kosovë nuk ishte spontan

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Është e qartë se sulmi i armatosur në veri të Kosovës të dielën nuk ishte spontan. Kështu ka thënë Charles Kupchan, profesor në Universitetin Georgetown dhe ish-drejtor i çështjeve evropiane në Këshillin e Sigurisë Kombëtare të Shteteve të Bashkuara në administratat e Bill Clintonit dhe Barack Obamas, në një intervistë për

“Radion Evropa e Lirë”.

“Duket se ky është një aksion i mirorganizuar, prandaj është më i rrezikshëm, sepse sugjeron se në terren ka grupe që janë të interesuara për të shkaktuar dhunë dhe janë të gatshëm të organizohen dhe të gjejnë armë që do t’u mundësojnë të bëjnë kështu”, ka thënë Kupchan.

Ai ka deklaruar se nuk dëshiron

të spekulojë se kush qëndron pas sulmuesve. “Mund të jetë një grup i brendshëm me mbështetje nga jashtë, por jo domosdo nga qeveria. Qëllimi i tyre? Të nxisin telashe, më shumë dhunë, t’i rrisin tensionet për të bërë të paarrtshëm bashkëpunimin e palëve të përfshira për ta arritur paqen e qëndrueshme”, ka thënë ai.



Sulmuesit në veri, ‘të strukturuar dhe të përgatitur’



PRISHTINË, 25 SHTATOR - Grupi i personave të armatosur që ka sulmuar pjesëtarët e Policisë së Kosovës në fshatin Banjskë të komunës së Zveçanit nuk është strukturë spontane, por e organizuar dhe e parapërgatitur mirë, thonë njohësit e çështjeve të sigurisë.

Avni Islami, profesor i shkencave të sigurisë në Prishtinë, ka vlerësuar se “formacioni imiton grupin mercenar rus Wagner”, ndërsa Mentor Vrajolli nga Qendra

Kosovare për Studime të Sigurisë ka thënë se ai nuk ka mundur të veprojë “pa dijen e autoriteteve të Serbisë”.

Një pjesëtar i Policisë së Kosovës është vrarë dhe disa janë plagosur të dielën në përleshjet me një grup të armatosur në pjesën veriore të vendit, të banuar me shumicë serbe. Autoritetet kanë thënë se rreshteri i policisë, Afrim Bunjaku, vdiq nga plagët e marra gjatë sulmit. Sipas tyre, sulmuesit e armatosur, rreth 30 syresh, ishin vendosur në

manastirin e Banjskës, nga ku shkëmbyen të shtëna me organet e rendit gjatë gjithë ditës së diel.

Ministri i Brendshëm i Kosovës, Xhelal Sveçla, ka thënë se tre sulmues janë vrarë, ndërsa gjashtë persona të tjerë, që dyshohet se ishin të lidhur me ta, janë arrestuar. Sipas Sveçlës, autoritetet kanë konfiskuar edhe një sasi të madhe armatimi.

Autoritetet e Kosovës kanë bërë përgjegjëse Serbinë për sulmin, ndërsa Beogradi zyrtar serbët e Kosovës.

Profesori Islami ka thënë për “Radion Evropa e Lirë” se grupi i armatosur, i cili sulmoi policinë në Banjskë, ishte një formacion i strukturuar dhe i përgatitur mirë. Sipas tij, grupi nuk ka funksionuar si i izoluar dhe i vetorganizuar, por si një formacion me uniforma, me

armatim specifik dhe i lidhur “me institucionet e sigurisë së Serbisë”.

“Uniformat e tilla i ngjajnë grupit (mercenar rus) ‘Wagner’. Duket se ky grup i strukturuar edhe ishte imitues i grupit ‘Wagner’, ka thënë Islami, duke iu referuar mercenarëve rusë që kanë marrë pjesë në luftën në Ukrainë dhe në zona të tjera konflikt. “Armët e gjata, armët luftarake, të gjitha ato janë armë që përdoren në vijën e parë të frontit nga afërsia. Këto janë të mjaftueshme që të thuhet se ky grup terrorist, i lidhur me shtetin serb, ka kryer terrorizëm shtetëror në një territor të huaj”, ka thënë Islami.

Kurse Vrajolli nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë ka thënë se bazuar nga mënyra se si është realizuar sulmi në Banjskë, nuk mund të thuhet se formacioni ka

kryer një akt spontan. Sipas tij, ai ka vepruar i orkestruar dhe me plan për ta destabilizuar pjesën veriore të Kosovës. Një gjë e tillë, ka thënë ai, nuk ka mundur të ndodhë pa dijen e autoriteteve të Serbisë. “Nëse flasim për mënyrën se si ata janë paraqitur, ajo tregon qartë se ata persona janë trajnuar, janë përgatitur, kanë marrë resurse mjaft të kushtueshme që të mund të operojnë. Mendoj se është e pamundshme që (autoritetet serbe) të mos i kenë informacionet. Tash lind pyetja: A ka qenë drejtpërdrejt shteti serb i përfshirë në këtë strukturë apo kanë qenë elemente radikale të përziera? Kjo është vështirë të konfirmohet. Por, pasi që ka persona të arrestuar, atëherë informacionet se kush i ka shtyrë ata që të organizohen, do të gjenden”, ka thënë Vrajolli.

Policia ekspozon armatimin e sekuestruar në Zveçan

Prishtinë, 25 shtator - Policia e Kosovës ka ekspozuar të hënën armatimin që ka sekuestruar në Zveçan. Policia ka njoftuar se grupet terroriste që kanë sulmuar policinë në veri kanë pasur sasi të madhe të armatimit.

“Sipas informacioneve fillestare, bëhet fjalë për gjetjen e dhjetëra, qindra armëve të llojeve dhe kalibrave të ndryshëm, uniforma dhe pajisje logjistike, përfshirë armë ushtarake të kalibrut të rëndë si granata, zolla, mitralozë, kallashnikov etj”, ka njoftuar policia.

Ndërsa ministri i Punëve të Brendshme, Sveçla, ka bërë me dije se përpos armëve, janë gjetur dokumente që dëshmojnë përfshirjen e kriminelit Milan Radojiçiq në këtë sulm terrorist. “Në këto materiale kemi gjetur dokumente të kriminelit Milan Radojiçiq, që dëshmojnë lidhjen e tij dhe pjesëmarrjen në këtë aksion. Kjo është lista e armëve, apo leje zyrtare të

institucioneve të Serbisë dhënë Milan Radojiçiq”, ka thënë Sveçla, duke shtuar se policia është ballafaquar me një numër sulmesh nga bandat në veri.

Në anën tjetër, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, ka thënë se dyshohet se nënkryetari i Listës Serbe, Milan Radojiçiq, ka qenë pjesë e sulmit të djeshëm ndaj policisë në veri. “Një nga automjetet ‘G-class’, me targa ‘BG 1107YY’, është gjetur një dokument i aplikimit të lejes për armë të personit Milan Radojiçiq, njëherësh nënkryetar i Listës Serbe. I njëjti është i dyshuar për përfshirje në disa vepra penale në Republikën e Kosovës. Dokumenti është i lëshuar nga autoritetet serbe duke ngritur dyshimin e fuqishëm se në mesin e personave të armatosur e uniformuar ka qenë edhe vetë Milan Radojiçiq”, ka thënë Hoxha.



ATK-ja ndryshon procedurat e rimbursimit

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar se ka ndryshuar Rregulloren mbi procedurat e rimbursimit. Sipas ATK-së, qëllimi i kësaj rregullore është të krijojë procedura për veprimet ligjore që do të ndërmerren në rastet kur bëhet fjalë për zbatimin e dispozitave për

rimbursime. “Qëllimi i Rregullores së brendshme të ATK-së 02/2023 mbi procedurat e rimbursimit është që përmes krijimit të procedurave të shkruara të përcaktohen veprimet ligjore që do të ndërmerren në rastet kur bëhet fjalë për zbatimin e dispozitave ligjore për rimbursime të Tatimit mbi

Vlerën e Shtuar (TVSh), Tatimit në të Ardhura Personale (TAP) dhe Tatimit në të Ardhura të Korporatave (TAK)”, ka njoftuar ATK-ja. Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga drejtori ekzekutiv i ATK-së. Rregulloren mund ta gjeni në uebfaqen e ATK-së www.atk-ks.org.



Guvernatori Ismaili merr mbështetje nga BE-ja për realizimin e objektivave të BQK-së



PRISHTINË, 25 SHTATOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, me bashkëpunëtorë, ka pritur të hënën në takim shefin e zyrës së Bashkimit Evropian (BE), Tomas Szunyog dhe zëvendësen e kësaj zyre, Eva Palatova. Në këtë takim guvernatori Ismaili ka shpalosur planet e BQK-së në funksion të realizimit të objektivave dhe planit

strategjik, me fokus reformimin dhe avancimin e kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse sipas legjislacionit përkatës të BE-së. Po në këtë takim është biseduar edhe për aktivitetet që ndikojnë në stabilitetin financiar, rritjen e qasjes në financa me fokus në ekonominë e gjelbër, përfshirjen në platformat globale të pagesave si dhe kartonin e gjelbër, nismat

rajonale për digjitalizimin e shërbimeve financiare dhe luftën kundër parave të falsifikuara. “Si aspekt i rëndësishëm që adresohet edhe përmes Programit të Reformave në Ekonomi (ERP) u diskutua për fuqizimin e kapaciteteve të BQK-së me profesionistë, me fokus në funksionet mandatare, si dhe nevojën e plotësimit të pozitive

kyçe sipas parimit të meritës dhe integritetit”, ka njoftuar BQK-ja. Sipas këtij njoftimi, shefi i Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, Tomas Szunyog, ka shprehur gatishmërinë e BE-së për ta mbështetur BQK-në për realizimin e objektivave dhe planeve të kësaj banke si institucion i pavarur dhe i rëndësishëm për ta siguruar

mandatin kushtetues dhe ligjor. “Guvernatori shprehu mirënjohjen e Bankës Qendrore për mbështetjen e treguar nga ana e BE-së për sistemin financiar dhe ekonominë e Kosovës përmes programeve të shumta të mbështetjes financiare, duke përfshirë mekanizmat nga institucionet e Bashkimit Evropian”, ka njoftuar BQK-ja.

Bizneset evropiane ‘vënë në pikëpyetje’ pozicionin e tyre në Kinë



BRUKSEL, 25 SHTATOR - Bizneset evropiane në Kinë po vënë gjithnjë e më shumë në pikëpyetje pozicionet e tyre përballë ligjeve të reja të sigurisë dhe një politizimi të tregtisë në këtë vend. Sipas komisionarit të Bashkimit Evropian për Tregtinë, Valdis Dombrovskis, kompanitë evropiane janë të shqetësuara për atë çfarë po ndodh në Kinë. “Kompanitë evropiane janë të shqetësuara me drejtimin e Kinës. Shumë prej tyre janë duke vënë në dyshim pozicionin e tyre në këtë vend”, ka thënë Dombrovskis. BE-ja është ankuar prej kohësh për

mungesën e kushteve të barabarta në Kinë dhe politizimin e mjedisit të biznesit. Shqetësimi u kthye në kujdes pas lëvizjes së Pekinit për t'i forcuar lidhjet me Moskën pavarësisht prej luftës në Ukrainë. Dombrovskis ka vënë në dukje ligjin e ri për marrëdhëniet me jashtë dhe një përditësim të fundit të ligjeve të Kinës kundër spiunazhit si “shqetësim të madh për komunitetin evropian të biznesit”. “Kjo do të thotë që kompanitë evropiane luftojnë për t'i kuptuar detyrimet e tyre të pajtueshmërisë: një faktor që ul ndjeshëm besimin e biznesit dhe

pengon investimet e reja në Kinë”, shtoi ai. Refuzimi i Kinës për ta dënuar luftën e Rusisë në Ukrainë përbën gjithashtu një “rrezik reputacioni”. “Pozicioni i Pekinit po ndikon në imazhin e vendit jo vetëm me konsumatorët evropianë, por edhe te bizneset”, ka thënë Dombrovskis. Kina ka kërkuar të pozicionohet si një palë neutrale në konfliktin e Ukrainës, ndërkohë që i ofron Moskës një rrugë shpëtimi jetike diplomatike dhe financiare derisa thellohet izolimi i saj ndërkombëtar.

BQK-ja: Vlera e depozitave arrin në 5.8 miliardë euro, kreditë në 4.7 miliardë euro

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Vlera e depozitave ka arritur vlerën e 5.8 miliardë euro, ndërsa e kredive në 4.7 miliardë euro. Kështu është thënë nga të dhënat e fundit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) mbi statistikën bankare për muajin gusht. “Vlera e depozitave në gusht 2023 arriti vlerën 5.83 miliardë

euro. Rreth 25 për qind e tyre janë të afatizuara. Ekonomitë familjare dominojnë me rreth 66.5 për qind të totalit të tyre apo rreth 3.88 miliardë euro. Depozitat e klientëve kanë shënuar rritje rreth 161.6 milionë euro krahasuar me muajin paraprak”, është thënë në raportin e BQK-së. Sipas BQK-së, vlera e

depozitave të reja është rreth 140 milionë euro. “Vlera e depozitave të reja në muajin gusht është 139.9 është milionë euro, në korrik ishte 105.4 milionë euro. Norma mesatare e interesit në depozita në muajin gusht ishte 2.52 për qind, në korrik ka qenë 2.69 për qind”, ka njoftuar BQK-ja.



Përpyjekja për kryengritje si momentum i ri



Hajdin ABAZI

Përpyjekja për kryengritje, që nisi dhe përfundoi me akt terrorist më 24 shtator, është një momentum i ri, që duhet të shërbejë si alarm për ta ndryshuar procesin e asaj që ka ndodhur deri më tash dhe për ta vënë në kahun e duhur dialogun.

Në orët e para të 24 shtatorit, një grup diversionist, i pajisur me armë, uniforma dhe automjete, atakoi një patrullë policore, duke e goditur me armë zjarri njëkohësisht nga shumë pozicione, që tregojnë për një organizim të mirëfilltë ushtarak. Në këtë pritë dhe luftim mbrojtës u vra një polic dhe një tjetër u plagos.

Ky nuk ishte fundi, por vetëm fillimi. Policia e Kosovës vepronte me shpejtësi, duke lokalizuar diversionistët. Qysh kur u rrethuan, epilogu mund të imagjinohej.

Duket se ishte planifikuar që fortifikimi të bëhej në manastirin e fshatit Banjskë, me besimin se pas vrasjes së policit shqiptar, policia e Kosovës do të vepronte si dikur policia serbe ndaj shqiptarëve: do të vriste të gjithë pa dallim si hakmarrje.

Kjo nuk ndodhi, me çka nuk u përmbushen pritjet dhe kalkulimet, e që çoi edhe në dështimin e kryengritjes së planifikuar.

Më 23 shtator, në ora 4 të pasdites, u takova me një mik e kolegë, dhe ndër shumë çështje, diskutuam edhe gjendjen në veri, si dhe nevojën për zgjidhjen e mirëfilltë të saj. Ndër të tjera, thashë se duket se ka nxitje që të reprizohen gjoja veprimet e UÇK-së, ani se kushtet e rrethanat janë krejt të kundërta. Deri të kjo kisha arritur përmes analizës. Nuk e besoja as vetë se të nesërmen do të ndodhte një përpyekje për kryengritje të armatosur nga diversionistë të hyrë nga Serbia.

Nuk ishte policia e Kosovës ajo që sulmoi, por ajo u sulmua. Manastirin serb u mor peng nga diversionistët, ani se brenda kishte klerikë dhe thuhet edhe pelegrinët.

Me përpyekjet për të shtrembëruar atë që po ndodhte, me sa duket Beogradi ka alarmuar se mund të arrestohen, ose vriten, ose maltreohen edhe klerikët dhe pelegrinët. Këtë shqetësim e shprehu edhe BE-ja. Fundi e tregoi se policia kosovare

ishte jashtëzakonisht profesioniste: diferencoi klerikët e pelegrinët nga diversionistët, duke i vënë këta të fundit në shënjestër. Dhe atyre u behej thirrje për dorëzim, por përgjigja ishte me armë zjarri, granata dhe zolla.

Sigurisht, hetimet duhet zhvilluar se a ishte e planifikuar që pelegrinët të përfshiheshin në aktet terroriste, apo ishte rastësi dhe keqpërdorim i objektivit religjioz.

Kjo sjellje e policisë do të duhej t'i jepte botës argumente se ata që ndiqen janë kriminelët, banditët, terroristët, por jo - në asnjë mënyrë - qytetarët e thjeshtë. Në një objekt ku pozicionohen diversionistët, të ruhet pastërtia e aksionit policor - ky është veprim shembullor dhe një shërbim i madh që iu bë atdheut, por edhe miqve ndërkombëtar.

Sulmi ndaj policisë, vrasja e njërit dhe plagosja e një tjetri, bëri perëndimin të reagojë me shpejtësi, dhe ta dënojë aktin terrorist. Ambasadori Hovenier ndezi dhe qirin për policin i vrarë! Borrel e quajti sulm terrorist, dhe ky është kualifikim i BE-së, sepse ai ishte i tillë.

Diversioni nuk ishte i rastit dhe spontan. Ai ka qenë mirë i përgatitur, sepse, sikurse e tha V. Surroi, inteligjenca e perëndimit kishte njoftuar se janë mbi 200 veta që stërviten në Serbi për t'u futur në Kosovë. KFOR-i dhe EULEX-i ishin në vëzhgim të veprimeve të policisë. Pra kishte dëshmitarë ndërkombëtarë - kjo është fatmirësi, sepse e vërteta raportohet nga forcat ndërkombëtare.

Prandaj, nuk ka asnjë dilemë se armatimi, uniformat, dhe automjetet nuk kishin nga të vinin në Kosovë, përpos nga Serbia. Kjo, pa më të voglin dyshim, do të dëshmohej.

Derisa ShBA, BE, NATO e Britania e Madhe e dënuan aktin terrorist, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, thirri konferencë për media në mbrëmje.

Logjika e thoshte se ai, të paktën sy e faqe botës, do të dënonte aktin terrorist. Por nuk e bëri këtë. Nuk ia nxori goja. E vetmja gjë që arriti të thoshte, ishte se "nuk duhej të vritej polici shqiptar, nuk duhej të ndodhte kjo". As formalisht nuk u dënua akti terrorist, as i veprimi diversionist, as akti i marrjes peng të manastirit të fshatit Banjskë. Nënteksti ishte se i vinte keq se përse nuk ka arritur të përmbushë skenarin, përse ai ka shkuar keq, ka dështuar.

Për më tepër, ai edhe më këtë rast, provoi të manipulonte opinionin dhe perëndimin. Ai tha se u vranë serbë, me snajperë nga policia e Kosovës. Ndërkohë, nga xhirimet, shihet se policia e Kosovës u bënte thirrje të dorëzoheshin, e ata

kundërpërgjigjeshin duke shtënë me armë, dhe ishte e qartë që në raste të tilla, veprohet për asgjësim ose eliminim. Dhe sapo u dorëzuan - askush më nuk u godit. Edhe këtu, policia kosovare tregoi nivel të lartë profesionist, që duhet çmuar lart.

Krahasimi midis grupit diversionist serb dhe UÇK-së, e madje edhe me familjen Jashari, ishte përpyekja më e ultë për të identifikuar krimin me rezistencën. Përderisa shqiptarët ishin të përndjekur nga shteti serb, u privoheshin të drejtat dhe maltreoheshin veç pse ishin shqiptarë dhe kundërveprimi ishte lëvizje për ta hequr dhunën ushtarake serbe, kjo nuk është gjendja e minoritetit serb në Kosovë - madje është e kundërta, dhe me këtë edhe nuk ka bazë reale për nismë çlirimtare.

Luftërat çlirimtare nuk mund të importohen, ato lindin vetëm te popujt e shtypur dhe baza e luftës çlirimtare është populli, prandaj kauza e UÇK-së ishte e drejtë - sepse nuk i kishte mbetur rrugë tjetër popullit shqiptar nën Serbi përveç se me kryengritje të armatosur të mbrohej nga terrori dhe etnogjenocidi serb. Krejt e kundërta është me minoritetin serb.

Kur Vuçiq i quan serbë diversionistët e vrarë, ai synon të thotë se po vriten serbët e Kosovës, qytetarët e thjeshtë e të pafajshëm. Ai e di mirë se ata janë mercenarë, por përpjetet të manovrojnë për të ngjallur hutitë për perëndimi.

Në të vërtetë, kur flitet për serbët në Kosovë, aty përfshihen disa kategori:

1. Komuniteti serb, që janë qytetarët civilë, ata që përbëjnë shumicën e minoritetit serb;
2. Lista serbe, që janë partitë politike të këtij minoriteti, të bashkuara nën presionin e Beogradit dhe të instrumentalizuara prej tij;
3. Bandat, paramilitarët dhe kriminelët e ndryshëm; dhe nga 24 shtatori edhe
4. Diversionistët, të futur nga jashtë si agresorë në territorin e Kosovës.

Presidenti serb e di mirë këtë dallim, por ai tri kategoritë e fundit i identifikon me kategorinë e parë, për të shtrembëruar të vërtetën dhe për të mashtruar perëndimin se gjoja shteti i Kosovës po i ndjekë pjesëtarët e komunitetit, kur, në fakt, kjo nuk ka ndodhë asnjëherë - të vetmit që janë ndjekur, dhe atë me mjaft kursim, është kategoria e tretë dhe tash edhe kategoria e katërt. Perëndimi, pas diversionit të 24 shtatorit, duhet ta korrektojë perceptimin e realitetit në Kosovë, dhe të mos lejohet manipulimi i Vuçiqit e i askujt me komunitetin serb kur bëhet fjalë për kategorinë e tretë dhe të katërt. Aq më tepër, që këto dy

kategori, bashkë me kategorinë e dytë, e mbajnë të shtypur, të ngulfatur dhe të privuar kategorinë e parë, pra vetë komunitetin serb.

Qeveritë e Kosovës kanë vepruar ndonjëherë ndoshta jo si duhet, me ndonjë nxitim dhe sidomos përjashtimisht pa u sinkronizuar me KFOR-in dhe EULEX-in, kundrejt kategorisë së tretë, por asnjëherë dhe në asnjë kohë nuk ka pasur ndonjë plan apo program kundër vetë minoritetit serb.

Gjithnjë ka qenë gabim, edhe kur ndërkombëtarët e kanë kërkuar, që të mos ndiqen bandat dhe paramilitarët, sepse ata nuk i binden paqes, por duan konflikt. Mos ndjekja e tyre me kohë, ka krijuar një strukturë që e shtyp edhe minoritetin serb.

Ndërkaq, Serbia gjithnjë ka vepruar me skenarë për të destabilizuar vendin, për të prolonguar marrëveshjen për paqe e stabilitetin, ani se vazhdimisht ka deklaruar për to, por nën tokë ka vepruar kundër, përmes instrumenteve të saja, dhe, në një farë mënyre, edhe duke e pushtuar nga brenda, minoritetin serb, duke mos i lejuar të jetojnë në realitetin e ri të Kosovës.

Shteti i Kosovës, dhe populli shqiptar është vullnetmirë për të jetuar në paqe dhe respekt të ndërsjellë me serbët e Kosovës, sepse, dashje pa dashje, historia i ka vënë në territorin e Kosovës dhe ata duhet të bashkëjetojnë me shekuj e mileniume, kur më nuk do të jenë qeveritë që i instrumentalizojnë interesat e minoritetit serb për qëllime shoviniste. Nga shteti i Kosovës vazhdimisht ata janë trajtuar si qytetarë të saj, dhe u janë dhënë të drejta e privilegje, që shqiptarëve në Luginë të Preshevës Serbia ua mohon.

Për perëndimorët diversioni i 24 shtatorit, duhet të shërbejë si një kampion alarmi për t'i zgjuar nga besimi i rremë se Vuçiq mund të ndërrojë "bigën", pra të braktisë kursin gjeopolitik agresor rus dhe të futet në kursin gjeopolitik euroatlantik.

Nëse kjo do të besohet se mund të bëhet me dialog si deri më tash - është lajthitje esenciale, sepse dialogun e ka shndërruar Serbia në një mekanizëm për rulet mashtrimi, ku në njërin anë pranon dialogun e në anën tjetër e ka prolonguar dhe mund ta prolongojë edhe një e dy dekada të tjera, pa arritur në një finale, pa ndonjë marrëveshje përfundimtare. Thjesht, sepse nuk e ka për qëllim paqen, sigurinë dhe stabilitetin, por të kundërtat, dhe sidomos veprimin për minimumin e shtetit të Kosovës kurrë nuk e ka ndërprerë, e me këtë edhe provokimin luftënxitës ndaj gjeostrategjisë euroatlantike në funksion të asaj ruse.

Kjo lojë destruktive duhet t'i ndërpritet Serbisë. Jo për shkak të shovinizmit serb, aspak, por për hir të popullit serb i cili përmes dialogut me Kosovën po mbahet i pushtuar, e aq me tepër për minoritetin serb - i cili po mbahet peng dhe nuk po lejohet të integrohet në lirinë e Kosovës.

Duket se ka pasur një dialogim me euroatlantikët për moseliminimin total të diversionistëve, dhe nëse kjo është e vërtetë atëherë është vepruar në sikroni dhe kjo i shërben paqes. Ky është një standard i lartë, dhe meriton respekt. E keqja duhet të minimizohet si për nga pasojat, ashtu edhe nga dëmi. Urrejtja e hakmarrja janë vlera të tejkaluara, zgjidhja dhe pjekuria janë vlera që sot çmohen.

Për qeverinë e Kosovës ky momentum duhet të jetë një pikë kthesë në raportet e saja me perëndimin përgjithësisht, e sidomos me ShBA-në dhe BE-në, për të vepruar tash e në të ardhmen në sinkroni për gjithçka.



Droja është se ky akt diversionist nuk do të jetë i fundit, sepse duket se nxitja gjeopolitike ruse për veprime agresore të Serbisë është e vazhdueshme. Kështu ishte kur u nis treni serb me parulla kundër Kosovës. Kështu ishte kur Serbia i vuri në lëvizje edhe aeroplanët luftarak gjoja nga rreziku i Kosovës. Kështu ishte edhe kur bandat e ndryshme sulmuan dhe forcat e KFOR-it. Kështu janë edhe këto njësite diversioniste.

Është propagandë e Beogradit ajo që gjoja minoriteti serb po ndiqet, po persekutohet, po arrestohet, burgoset e vritet. Kjo absolutisht nuk është e vërtetë. Nuk ka asnjë rast të vetëm, që ndonjë serb të jetë arrestuar për mendimin e lirë, besimin religjioz ose përkatësinë e tij etnike, veprime këto që për një shekull Serbia i kishte bërë kundër shqiptarëve.

Serbia po dëshiron ta hapë me çdo çmim një front të dytë lufte në Kosovë - krahas frontit të parë rus në Ukrainë dhe në shërbim të tij, e do të ishte gabim strategjik i perëndimit që në heshtje ta lejohet të ndodhë kjo. Diversioni i 24 shtatorit duhet të kuptohet si një "thikë pas shpine" për perëndimin. Nëse përpyekja për kryengritje nuk do të merret seriozisht, atëherë do të çohet mesazhi i gabuar.

Serbia e kërkon zgjidhjen të dhuna e te lufta, kurse Kosova duhet ta kërkojë të politika, vetëm te politika, me konstruktivitet dhe me bashkërendim proaktiv.

Ky momentum nuk duhet të ikë, po duhet të shënojë kthesën, që çon në zgjidhjen e qëndrueshme, të paqes, sigurisë dhe stabilitetit.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Federata e Karatesë paralajmëron padi ndaj MKRS-së

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Kuvendi i Jashtëzakonshëm i Federatës së Karatesë, i mbajtur më 4 korrik, në të cilin Besart Baruti u zgjedh kryetar i kësaj federate, është shpallur i pavlefshëm dhe me shkelje ligjore nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport. Në vendimin e MKRS-së thuhet se ai kuvend është mbajtur duke shkelur Ligjin për Sport, Statutin e Federatës së Karatesë si dhe Udhëzimin Administrativ për Kriteret e Licencimit të Federatave, ndërkohë që në vendim, po ashtu, kërkohet që kuvendi i ri të mbahet brenda 45 ditëve.

Mbajtjen e kuvendit të ri zgjedhor po e kërkon edhe ish-kryetari i FKK-së, Avni Gashi. Ai për "KosovaPress" ka thënë se zgjedhja e Besart Barutit në vend të tij është bërë duke shkelur statutin e Federatës së Karatesë, andaj për ta kthyer ligjshmërinë duhet mbajtur kuvendi i ri. Por, i bindur se nuk është shkelur as Ligji për Sport e as statuti i FKK-së është sekretari i Federatës së Karatesë, Nazmi Gashi. Ai thotë se thirrja e kuvendit të 4 korrikut është bërë duke respektuar plotësisht statutin e FKK-së. Madje Gashi ka thënë se do ta padisin MKRS-së për ndërhyrje arbitrare në federatë për shkak të, siç thotë ai, interesave të disa individëve. "Unë mendoj që janë disa interesa të disa individëve aty brenda edhe në MKRS edhe jashtë saj të cilët po ndërhyjnë. Janë disa interesa të cilat ne si federatë nuk po i kuptojmë qartë sepse të ndërhyhet në një autonomi të një federate në këtë formë, kjo është shumë arbitrare, është shumë e dëmshme për organizatat joqeveritare që veprojnë, në këtë rast federatave sportive... (09:05...) MKRS-ja është duke na shtyrë ne, duke na bërë presion që ne ta thërrasim



një kuvend anti-statutar, që nga kryetari aktual dhe administrata e FKK-së nuk do të lejohet të ftohet një kuvend zgjedhor që me vetëdije e dimë që po e shkelim statutin... Në këtë lojë, në këtë sistem, ne nuk do të jemi në presion, ne do t'i padisim të gjitha këto organe që i kanë rekomanduar ministrit për këto lloj veprimesh. Do të paditet MKRS-ja. Do të paditen zyrtarët të cilët nuk kanë qenë korrektë dhe kanë prodhuar një raport i cili është i dëmshëm për Federatën e

Karatesë së Kosovës", ka theksuar Gashi.

Për situatën e krijuar në FKK ka reaguar edhe presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi. Ai ka thënë se nuk është MKRS-ja e as KOK-u që përcaktojnë zgjedhjen e organeve të një federate, por vetëm anëtarët e saj, ashtu siç para sheh statuti i FKK-së. Edhe pse ende nuk është bërë e ditur data, sekretari i Federatës së Karatesë, Nazmi Gashi, ka thënë se kuvendi i ri do të ftohet së shpejti.

SHKURT

Xavi: Muriqi është futbollist cilësor

Barcelona të martën është mysafire e Mallorcas. Një ditë para kësaj ndeshjeje ka folur trajneri Xavi Hernandez. Strategu spanjoll fillimisht e ka vlerësuar skuadrën kundërshtare, por edhe sulmuesin e Përfaqësueses së Kosovës, Vedat Muriqi. "Mallorca është një ekip i vështirë, mbrojtja ka mbështetje nga pjesa tjetër e ekipit. Është një skuadër shumë e fortë fizikisht, që luan direkt me futbollistë cilësorë si Muriqi apo edhe Darder. Është një udhëtim i komplikuar për ne sepse ata vijnë nga humbja e pësuar nga Girona", ka thënë Xavi. Muriqi e pati një sezon fantastik në edicionin e kaluar me 15 gola të realizuara, kurse në këtë fillim sezoni i ka shënuar dy gola nga gjashtë ndeshje të zhvilluara.

Broja pas rikthimit: Ndjenjë e pabesueshme. Faleminderit për mbështetjen!

Sulmuesi i Shqipërisë, Armando Broja, është shprehur i lumtur që është rikthyer në fushën e gjelbër pas shumë muajsh, derisa ka shprehur keqardhje për humbjen nga Aston Villa. Sulmuesi kuqezi u inkuadrua në lojë në minutën e 79, duke e zëvendësuar Caicedon. "Natyrisht nuk është rezultati që prisnim, por çfarë ndjesie e pabesueshme dhe emocionale të kthehesh në fushë pas kaq shumë muajsh jashtë. Faleminderit djema për mbështetjen dhe faleminderit të gjithëve që punuan për kthimin tim!", ka shkruar Broja në "Instagram".

CIES: Qazim Laçi renditet i dyti në botë për asistime

Futbollistët shqiptarë vazhdojnë shkëlqimin në kampionatet evropiane. Mesfushori i Kombëtares së Shqipërisë, Qazim Laçi, i cili luan në Sparta Pragën e Çekisë, po mahnit me paraqitje. CIES ka publikuar një statistikë të fundit sa i përket produktivitetit në asistimet e dhëna deri tani në të gjitha kampionatet në botë. Qazim Laçi mban vendin e dytë në botë, me 1.13 asistime të dhëna për 90 minuta. Almoez Ali i Al Duhaile renditet i pari në botë me 1.33 asistime, ndërsa në vendin e tretë, pas mesfushorit shqiptar, gjendet Alvaro Fernandes i Bragës.

Gashi-Macula dhe presidenti i KOK-ut flasin për Lojërat Mesdhetare 2030

Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi, është takuar me drejtoreshën e Pallatit të Rinisë dhe Sportit në Prishtinë, Mrika Gashi-Macula. Drejtoresha Gashi-Macula është shprehur e nderuar që ka pritur në takim të parin e KOK-ut, Ismet Krasniqi, pas arritjes së jashtëzakonshme për t'i organizuar Lojërat Mesdhetare 2030. "Biseduam miqësisht për rrugëtimin deri te ky sukses. Nga ana e tij, Ismet Krasniqi tregoi rreth përgatitjeve dhe sfidat që i presin", ka thënë ajo. Ndërsa kreu i KOK-ut e falënderoi drejtoreshën e Pallatit të Rinisë dhe Sportit për punën e madhe që po bën. "Kemi bashkëpunim shumë të mirë dhe jam falënderues për punën që po bën drejtoresha, e cila është gjithmonë e hapur për projektet e mëdha që e presin Pallatin e Rinisë, pasi është fokusi ynë i radhës, ta realizojmë punën tonë që gjithçka të shkojë si duhet", ka deklaruar Krasniqi.

Erik Copes, MVP i javës së parë

PRIZREN, 25 SHTATOR - KB Bashkimi shënoi fitore ndaj Golden Eagle Yllit në Suharekë. U dallua qendra Erik Copes. Ai ndaj therandasve e mbylli ndeshjen me dyshifror të dyfishtë 25 pikë e 14 kërcime, duke pasur indeksin 32, apo

më të lartin e kësaj xhiroje dhe duke fituar çmimin MVP për herë të parë në këtë edicion të elitës. Trepça e nisi edicionin me fitore bindëse ndaj Istogut, ku u dallua dyshja Drilon Hajrizi dhe Amin Hot. Hajrizi ndaj Istogasve kishte 20 pikë,

nëntë kërcime dhe pesë asistime, kurse Hoti kishte 18 pikë, katër kërcime dhe katër asistime. Fitoren e parë në vazhdim e realizoi Sigal Prishtina, që mundi në Prizren skuadrën e Proton Cable Prizrenit, kurse lojtari më i dalluar te skuadra

kryeqytetase ishte Nick Ward me 25 pikë, tetë kërcime dhe një asistim. Peja si kampione e nisi me fitore, ku mundi Vëllaznimin, kurse te skuadra verdhezi u dallua Beck Terwell me 20 pikë, gjashtë kërcime dhe një asistim.



Ancelotti pas humbjes nga Atletico: Problemi ishte mbrojtja, jo sulmi

MADRID, 25 SHTATOR - Real Madridi e humbi ndeshjen derbi nga Atletico Madridi (3-1). Trajneri Carlo Ancelotti është shfaqur i zhgënjyer nga ajo që skuadra e tij dha në fushën e lojës, ndërsa mori përgjegjësinë për këtë

humbje që i kushtoi dhe vendin e parë në renditjen e La Ligas. “Tre golat e pësuar ishin fotokopje me një-tjetrin për shkak se qendërmbrojtësit nuk ishin vendosur mirë në zonë. Diferencën e bëri dhe fakti se

Atletico është një nga skuadrat më të mira në mbrojtje. Janë shumë të fortë në duela dhe është e vështirë që të gesh hapësira kundër tyre. Problemi në këtë ndeshje ishte mbrojtja, jo sulmi. Marrja e përgjegjësisë është

minimumi. Unë e pranoj se është faji im. Ne tentuam shumë deri në momentin që pësua golin e tretë, kur gjithçka përfundoi. E përsëris: nuk e kishim problemin te sulmi në këtë ndeshje”, ka deklaruar Ancelotti.



Jakup Berisha, ‘Ylli i javës’ në Superligë

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Mesfushori i FC Feronikeli '74, Jakup Berisha, e ka fituar çmimin “Ylli i javës” në xhiron e 6 të Albi Mall Superligës. Komisioni i veteranëve të futbollit në përbërje: Bujar Asllani, Milaim Humolli e Blerim Haxholli, vendosi që epiteti i më të mirit për këtë xhiro t'i takojë mesfushorit të “Niklit”, pasi në ndeshjen në udhëtim kundër FC Liria pati paraqitje të mirë, teksa shënoi edhe dy gola, duke kontribuar që skuadra e tij të fitojë tri pikë të reja, duke e përmbysur rezultatin nga 3-0 në 3-5. Pasi mori këtë çmim, Berisha u shpreh i lumtur për vlerësimin dhe për faktin që skuadra e tij tregoi karakter të lartë, duke u rikthyer nga disavantazhi prej tre golash. “Të shpallësh më i miri i xhiros është një ndjenjë e veçantë, sidomos në një ndeshje si ajo e ditës së djeshme, e cila ishte e papërshkrueshme dhe e para në karrierën time që më solli



emocione të tilla. Të gjithë janë befasuar me përmbysjen e rezultatit nga 3-0 në 3-5 që e bëri skuadra jonë, por kjo tregon karakterin e ekipit tonë. Jam shumë i lumtur për fitoren dhe për faktin që e kam ndihmuar ekipin të arrijmë një tjetër fitore të vlefshme në Albi Mall Superligë.

Falënderoj bashkëlojtarët, stafin e trajnerëve, tifozët dhe të gjithë ata që besojnë te ne. FC Feronikeli 74 nga ndeshja në ndeshje do të hyjë për rezultate pozitive dhe besoj që me punën që po bëjmë do të arrijmë pikë maksimale në çdo ndeshje”, ka thënë Berisha për faqen zyrtare të FFK-së.

Vanessa Bryant: Shpëtoni vizatimin në mur dedikuar Kobe Bryantit

LOS ANXHELOS, 25 SHTATOR - Nodhet në një mur në Hardcore Fitness, një palestër në Downtown të Los Anxhelos, një nga pikturat në mur më të bukura në botë dedikuar Kobe Bryantit. Një pikturë muri që tifozët e Lakersave dhe të ish-basketbollistit e duan dhe e pëlqejnë shumë. Jo vetëm ata, por edhe bashkëshortja e Kobes, Vanessa Bryant, e adhuron atë vizatim, që rrezikon të zhduket përgjithnjë. Ai vizatim në mur dedikuar Kobe Bryantit dhe vajzës së tij Gina, që humbën jetën në një aksident tragjik me helikopter në janar 2020, është pikturuar nga një artist i zonës, Sloe Motion. Ai që synon të heqë atë pikturë në mur është pronari i pallatit, që ka urdhëruar personin që drejton palestrën e fitnessit, që ta fshijë atë brenda vitit. Synimi i pronarit është ta shesë hapësirën e murit për reklama. “Nëse nuk e fshij deri më



31 dhjetor, atëherë do të vijë vetë pronari që ta fshijë, duke më ngarkuar çdo shpenzim”, ka thënë Cecilia Moran, personi që drejton palestrën. “Refuzoj që ta fshij atë vizatim, pasi mendoj se nuk është e drejtë dhe do të luftoj që ai vizatim në mur të qëndrojë përgjithnjë”, ka thënë më tej ajo. “Nuk është e drejtë

të fshish diçka që ka pasur një impakt kaq të madh te kaq shumë njerëz”, tha Moran. Në mbështetje te saj është Vanessa Bryant, që ka nisur një peticion online në “Instagram”, për ta shpëtuar atë vizatim në mur. Deri më tani ajo ka mbledhur 60 mijë firma, ndërkohë që synon 75 mijë firma.

SHKURT

Kane: Shpresoj të shënoj edhe më shumë gola

Bayern Munchen e shkaktoi Bochumin duke e mposhtur me rezultatin e thellë 7-0. Protagonist kryesor në këtë sfidë ishte sulmuesi Harry Kane, autor i një “tripletë”. “Bomberi” anglez është përshtatur shpejt me ekipin e tij të ri teksa ka shënuar 7 gola në Bundesligë, golashënuesi i dytë më i mirë, ndërsa ka shënuar dhe 1 gol në Ligën e Kampionëve kundër Manchester Unitedit. “Jam i lumtur që mund ta ndihmoj skuadrën në arritjen e objektivave. Skuadrën po e njoh gjithnjë e më mirë. Ndihej realisht i lumtur. Shpresoj të shënoj edhe më shumë gola në të ardhmen”, ka thënë Kane.

Lëndimi i Mbappes nuk është serioz

Lëndimi i Kylian Mbappes nuk është serioz, ka konfirmuar trajneri Luis Enrique. Sulmuesi francez është dashur të zëvendësohet pas një dueli që pati me Leonardo Balerdin. “Nuk është diçka serioze, por ndiente dhimbje. Mendoj se ishte më e zgjuar të largohej. Është një goditje, por ai është mirë”, ka thënë Enrique. Ndryshe PSG-ja shënoi fitore bindëse ndaj Marseillet (4-0).

Van Basten: Futbollit në Holandë duhet të ndalet

Derbi i madh holandez mes Ajaxit dhe Feyenoordit nuk përfundoi, pasi u ndal në minutën e 56 shkak i trazirave nga tifozët. Skuadra mysafire nga Roterdami dominoi klasiken e futbollit holandez, duke kryesuar 0-3 përballë “Harkëtarëve” deri në minutën e 56, kur sfida u ndërpre për të mos nisur më. Tifozët e Ajaxit, të zhgënjyer dhe zemëruar nga turpërimi në De Klassieker, nisën të shkatëronin trazira në stadium. Hedhja e mjeteve piroteknike në fushë, shoqëruar me përplasjen e tifozëve, detyroi gjyqtarin kryesor që ta pezullonte përfundimisht takimin e zjarrtë të Eredivisie. Pas daljes nga stadiumi, tifozët vazhduan vandalizmin në Amsterdam, duke shkatërruar gjithçka që u doli para. Në lidhje me ngjarjen ka reaguar ashpër Marco Van Basten, legjenda e Milanit dhe futbollit holandez, i cili foli për “Ziggo Sport” duke thënë se futbollit duhet të ndalet. “Futbollit profesionist në Holandë duhet të ndalet. Është e nevojshme ta marrim këtë masë. Duhet ta bëjmë. Mjaft me futbollin profesionist në Holandë. Nuk mund të shohësh gjëra të tilla”, ka thënë Van Basten.

Unitedi zhgënjehet me Onanan, synon transferimin e Oblakut

Andre Onana po e zhgënjën Manchester Unitedin me portierin kamerunas që ka pësuar deri tani 10 gola në 6 ndeshje të luajtura në Premierë Ligë. Duket se drejtuesit e klubit nga “Old Trafford” nuk kanë siguri te 27-vjeçari dhe kanë nisur punën për të gjetur menjëherë zëvendësuesin e tij, edhe pse morën verën e shkuar për plot 60 milionë euro nga Interi. Siç raportojnë mediet britanike, “Djajtë e Kuq” po synojnë transferimin e portierit Jan Oblak. Slloveni prej vitesh mbron portën e Atletico Madridit, duke u spikatur si një nga gardianët më të mirë në botë. Për këtë arsye Unitedi ka bërë gati një ofertë prej 50 milionë eurosh në mënyrë që madrilenët ta lënë të lirë Oblak në janar.

Pochettino: Pronarët janë të zhgënjyer

Chelsea ka pësuar humbje në ndeshjen ndaj Aston Villës (1-0), derisa kriza është thelluar edhe më shumë në këtë fillim

të sezonit të ri të Premierë Ligës. Në gjashtë ndeshjet e zhvilluara, “Blutë” kanë vetëm një fitore, dy barazime dhe tri

humbje duke u renditur kështu në vendin e 14-të në tabelë me pesë pikë. “Po, sigurisht që pronarët janë të

zhgënjyer, por në të njëjtën kohë ata duhet ta mbështesin planin. Ne kemi skuadrën që kemi, duhet të përpiqemi ta

ndërtojmë besimin dhe t'u japim të gjithë mbështetjen që u nevojitet”, ka thënë Mauricio Pochettino, trajner i Chelseat.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook




www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Arian Durmishaj, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës se mesme te larte "Dr. Xheladin Deda" Mitrovicë.

- Veton Haliti, shpall te pavlefshme dëftesat e vitit të parë, dytë dhe tretë të shkollës se mesme të lartë "Arkitekt Sinani".

- "Furteria Gashi", shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 810550906, Mitrovicë.

- Arian Karakashi B.I, shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 811503350.

- Drita Nimani, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Osman Rama".

- AHB GROUP SH.P.K, shpall te pavlefshme certifikatën e Tvsh-së me numër: 330403022.

- Lule Milici shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme teknike "Nexhmedin Nixha".

- Blerton Miftari, shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "SHABAN IDRIZI".

- Blina Karakashi, shpall të pavlefshme dëftesën e klasës se 11 të shkollës se mesme "DR. XHELADIN DEDA".

- Endrit Shabani, shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "MIGJENI".

- Jeton Hamiti, shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 1 deri 9 te shkollës fillore "HARUN BEKA", (Ish-shkolla "Bajram Curri")

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

